



## KONFERENCË SHTYPI MË 19 NËNTOR 2001.

Në datat 24 tetor – 6 nëntor, Shqipërinë e vizitoi misioni i radhës i FMN-së i EU1. Çështja kryesore ku u përqendrua vëmendja ishte diskutimi i programit ekonomik të vendit për vitin 2002 si edhe e strategjisë afatmesme për periudhën 2002 – 2004. Më konkretisht, diskutimet e Bankës së Shqipërisë me misionin u përqendruan në çështje të tilla si zhvillimet në prodhim, çmimet e konsumit, përcaktimi i programit monetar, politika e Bankës së Shqipërisë në lidhje me normat e interesave, zhvillimet në sistemin bankar dhe privatizimin e Bankës së Kursimeve si dhe përgatitjet për hyrjen në qarkullim të euros fizike. Nga diskutimet u konkludua për objektivat përfundimtarë të vitit 2001 si dhe për objektivat e vitit 2002. Në përgjithësi, u arrit në përfundimin që edhe për vitin 2001, ekonomia shqiptare ka ecur brenda kuadrit të programuar dhe pritet të sigurojë arritje të objektivave. Këto zhvillime kanë krijuar një bazë të mirë për të mundësuar nënshkrimin e marrëveshjes trevjeçare si dhe për të siguruar zbatim të mirë të strategjisë për nxitjen e rritjes dhe reduktimin e varfërisë.

### I. ZHVILLIMET NË PRODHIM

Për vitin 2001 synohet të realizohet një rritje prodhimi prej 7.3 për qind, megjithëse në gjashtëmuorin e dytë u krijuan disa vështirësi për shkak të situatës së rënduar energjitike si dhe të ngadalësimit të përgjithshëm të ritmeve të rritjes së ekonomisë botërore pas sulmeve terroriste të 11 shtatorit 2001.

Në tërësi, për ekonominë shqiptare është karakteristike që muajt e stinës së verës (korrik dhe sidomos muaji gusht) shënojnë një lloj “qetësimi” në aktivitetin ekonomik, duke u shoqëruar me reduktim të vëllimit të prodhimit, për t’u rigjallëruar në stinën e vjeshtës. Kjo evidentohet në pjesën më të madhe të treguesve të disponueshëm.

Në përgjithësi, pritet që rritja e **prodhimit bujqësor** të jetë rreth 1 pikë përqindjeje më pak se sa parashikimi në fillim të vitit. Kjo ka ardhur kryesisht si pasojë e reduktimit në rritjen e prodhimit në bujqësi ndërkohë që, prodhimi i agroindustrialisë dhe i peshkimit ka ruajtur nivele të kënaqshme rritjeje.

**Prodhimi industrial në sektorin shtetëror** gjatë tremujorit të tretë të vitit 2001 qëndron në nivele relativisht më të larta se sa tremujori i dytë, por me tendencë në ulje nga muaji në muaj. Gjithësesi, ky gjallërim relativ i prodhimit në këtë sektor, ka ndikuar në ruajtjen e objektivit për rritje ekonomike.

**Tabela 1: Indeksi i prodhimit industrial.**

Në % kundrejt vitit 1993	2001			
	T2	Korrik	Gusht	Shtator
Prodhimi industrial në volum	43.9	61.7	59.4	54.3
- Industria nxjerrëse	29.1	27.3	27.8	26.9
- Industria përpunuese	33.6	22.7	71.4	33.8
- Prodhimi i energjisë elektrike	116.5	114.4	68.6	83.4

Burimi: INSTAT, "Muaji shkurtimish", korrik, gusht, shtator 2001.

Prodhimi mall i shitur në tremujorin e tretë të vitit 2001, gjithashtu, ka manifestuar rënie krahasuar me tremujorin e dytë në masën 16.4 për qind.

Treguesit për **sektorin e transportit hekurudhor** manifestojnë një reduktim të vëllimit të punës në udhëtarë, në mallra por edhe në ngarkim-shkarkim. Në mënyrë të vazhdueshme, të tillë tregues kanë rënie për gjatë gjithë tremujorit të tretë.

**Tabela 2: Treguesit në transportin hekurudhor.**

Volumi i punës	2001		
	Korrik	Gusht	Shtator
Udhëtarët			
- mijë udhëtarë	312	299	210
- mijë udhëtarë për km	15823	16528	11746
Mallra			
- mijë ton	27	25	17
- mijë ton për km	2112	1676	1334
Ngarkim-shkarkim (mijë ton fizik)	259	252	237

Burimi: INSTAT, "Muaji shkurtimish", korrik, gusht, shtator 2001.

**Tregtia e jashtme**, në mënyrë më tipike, pasqyron karakteristikën e ngurtësimit të aktivitetit në muajt korrik-gusht dhe gjallërimin e tij në muajin shtator e në vijim.

**Tabela 3: Tregtia e jashtme.**

Në miliardë lekë	2001		
	Korrik	Gusht	Shtator
Eksportet	2.7	2.1	3.7
- riekportet	2.1	1.5	2.8
Importet	15.9	13.1	16.9
Deficiti tregtar	13.2	11.0	13.2

Burimi: INSTAT, "Muaji shkurtimish", korrik, gusht, shtator 2001.



Në mungesë të të dhënave më të detajuara për eksportet, por sidomos për importet është e vështirë të përcaktohen faktorët që kanë çuar në rritjen e konsiderueshme të importeve në muajin shtator. Megjithatë, në përgjithësi tendenca është që importet të rriten ndjeshëm në tremujorin e fundit të vitit dhe deficitit tregtar të thellohet më tej. Gjatë këtij viti, si pasojë e ngadalësimit të ekonomisë globale, vërehen rënie çmimesh të mallrave bujqësore me rreth 6-8 për qind, të metaleve me 4 për qind (përveç arit dhe argjendit) dhe të çmimeve të naftës në tregjet botërore<sup>1</sup>. Kjo do të bëjë më të lira importet ndërkohë që, kërkesa e jashtme për eksporte mund të bjerë. Treguesit e **punësimit**, sipas të dhënave zyrtare, janë në përmirësim të vazhdueshëm. Numri i të papunëve prej kohësh po paraqet një tendencë të qartë në rënie gjë që mendohet se sigurohet nëpërmjet gjallërimit të sektorit privat, pasi në përgjithësi sektori shtetëror është në tkurrje.

Tabela 4: Tregues të punësimit.

Treguesit (në mijë)	2001			
	T2	Korrik	Gusht	Shtator
Të papunë gjithsej	192	188.7	187	184
Kanë filluar punë gjatë muajit (vetë)		494	490	259
Të punësuar gjithsej:	1 077	1 077	1 077	1 074
sektor shtetëror	197	197	197	194
sektor privat bujqësor	761	761	761	761
sektor privat jobujqësor	119	119	119	119

Burimi: INSTAT, "Muaji shkurtimish", korrik, gusht, shtator 2001.

Siç e theksova më sipër, të paktën dy janë problemet që mund të kenë ndikime negative në ekonominë shqiptare jo vetëm deri në fund të vitit 2001, por edhe për vitin e ardhshëm:

- *situata energjitike në vend*. Të dhënat e raportuara flasin për një reduktim të ndjeshëm të prodhimit të energjisë elektrike në muajt gusht e shtator krahasuar me muajin korrik. Po kështu, prodhimi mall i shitur prej KESH në tremujorin e tretë të vitit 2001 rezulton me rënie prej rreth 20 për qind kundrejt tremujorit të dytë. Prodhimi në vend i energjisë elektrike nuk po jep shenja përmirësimi. Kjo do të thotë që ekonomia shqiptare do të mbështetet ndjeshëm nga importi i energjisë elektrike. Rritja e çmimit të energjisë elektrike nëpërmjet prezantimit të dy tarifave është një masë që çon në një zgjidhje të pjesshme të problemit të furnizimit me energji elektrike. Kjo masë redukton barrën e subvencionimit nga ana e buxhetit të shtetit si dhe përafron çmimin e energjisë elektrike me atë të tregut duke synuar që të racionalizojë konsumin e energjisë elektrike në kushtet e mungesës së tij. Megjithatë, që kjo masë të jetë e efektshme është e domosdoshme që paralelisht, nga ana e autoriteteve përkatëse, të punohet në disa drejtime:

<sup>1</sup> Burimi: World Bank "Impact of recent events on low and middle-income countries: Response of the World Bank Group", 7 nëntor 2001.

- administrimi më i mirë i rrjetit shpërndarës dhe reduktimi i humbjeve. Nuk duhet që rritja e çmimit të energjisë të shoqërohet me rritje të humbjeve në rrjet (pra të mospagimit) sepse kjo masë do të kthehej në penalizim për atë pjesë të popullsisë dhe të biznesit të cilët janë të rregullt në shlyerjen e detyrimeve të tyre;
- përmirësimi i cilësisë së shërbimit të furnizimit me energji. Rritja e çmimit ka nevojë të shoqërohet me cilësi më të lartë të shërbimit duke filluar nga rregullshmëria e ndërprerjeve të energjisë deri në riparimin e shpejtë të difekteve që mund të krijohen;
- lehtësimi i përdorimit të burimeve alternative të energjisë nëpërmjet ofrimit të lehtësive fiskale apo zgjerimit të konkurrencës në këtë treg. Kjo do të ndikonte në përdorimin më të reduktuar të energjisë elektrike;
- rikonstruktimi i rrjetit shpërndarës, privatizimi, madje i shpejtë edhe i sistemit elektroenergjitik, si dhe lejimi i konkurrencës në ndërmarrjet që do të administrojnë shpërndarjen e energjisë elektrike si edhe alternimi i burimeve të sigurimit të energjisë elektrike janë të tjera masa që do të ndikojnë në përmirësimin afatgjatë të situatës energjitike.

Përmirësimi i furnizimit me energji elektrike është kthyer tashmë në një problem jetik për ekonominë shqiptare. Siç e kam theksuar dhe herë të tjera, ekonomia nuk mund të zhvillohet me gjeneratorë. Dëmi që i shkaktohet ekonomisë tashmë është i një natyre afatmesme, pasi ai do të kthehet në një faktor të rritjes së kostos së prodhimit dhe i reduktimit të rritjes ekonomike, sidomos në sektorin e industrisë;

- *ngadalësimi i rritjes së ekonomisë botërore.* Ekonomia shqiptare nuk ka integrim të konsiderueshëm me ekonominë botërore. Pesha e volumit të tregtisë ndaj PBB-së<sup>2</sup> për muajin shtator 2001 është 2.8 për qind. Kjo bën që ekonomia jonë të mos jetë shumë e ekzpozuar ndaj goditjeve të jashtme. Për pasojë, ndikimi i problemeve të ekonomisë botërore do të ndihet ose më i reduktuar ose në një kohë të mëvonshme. Masa e ndikimit do të varet kryesisht nga shkalla me të cilën do të preken dy partnerët kryesorë të Shqipërisë: Italia dhe Greqia. Ndikimet në ekonominë shqiptare mund të jenë të dyanshme. Është e vështirë, aktualisht, të paraqitet një pritshmëri e saktë për arsyen se ka ende paqartësi për ecurinë që do të ketë ekonomia botërore në tërësi. Përveç një konfirmimi që sulmet terroriste ngadalësu

---


<sup>2</sup> PBB është vlerësim për vitin 2001.



rritjen globale, nuk dihet ende si do të reagojnë ekonomi të veçanta. Kështu, një skenar i mundshëm është reduktimi i punësimit të emigrantëve shqiptarë në Greqi e Itali. Kjo do të shoqërohet me reduktim të dërgesave normale të emigrantëve që mund të ushtrojë presione në kursin e këmbimit dhe për pasojë në nivelin e çmimeve të konsumit. Nga ana tjetër, kthimi i mjaft emigrantëve në vend mund të shoqërohet me prurje të kursimeve afatgjata të tyre dhe investim brenda vendit për të filluar një aktivitet ekonomik. Po kështu, mund të ketë reduktim të përgjithshëm të investimeve si pasojë e pasigurisë. Kjo mund të ndikojë si në reduktimin e nivelit të investimeve të huaja direkte në vend ashtu edhe në një ngadalësim të procesit të privatizimit. Gjithësesi, investimet e huaja në Shqipëri prej kohësh kanë qenë në nivele të ulëta saqë ato mund të paraqiten inelastike (pothuaj të pandjeshme) nga ngjarje të tilla. Nga ana tjetër, duke qenë se tashmë kemi një hartë më të madhe pasigurie, investitorët mund të paraqiten më të guximshëm dhe të kthejnë sytë në rajone të tilla si Shqipëria për të investuar etj..

## II. ZHVILLIMET NË ÇMIMET E KONSUMIT

Në vitin 2001 ecuria e çmimeve të konsumit ishte e ndryshme nga viti 2000. Në mënyrë të vazhdueshme, në tetë muajt e parë të vitit, inflacioni erdhi duke u rritur, duke arritur nivelin më të lartë në muajin korrik, prej 5.6 për qind, nivel i cili kalonte ndjeshëm kufirin e sipërm të intervalit objektiv prej 4 për qind. Ndërsa në dy muajt vijues inflacioni vjetor ka arritur në reduktim për të arritur në fund të muajit tetor në 1.8 për qind.



Grafiku 1.

Kështu, në ndryshim nga viti 2000, por dhe nga tendencat e përgjithshme të vërejtura në vite, në vitin 2001 është manifestuar:

- ndikim më i pakët i efekteve sezonale, sidomos i periudhës së stinës së verës;
- nivel mesatarisht më i lartë i inflacionit në vitin 2001 krahasuar me vitin 2000 (rreth 3.1 pikë përqindjeje);
- ekzistenca e një sërë faktorëve *shock* të krahut të ofertës, të cilët pasuan njeri-tjetrin duke u shndërruar në faktorë me veprim të përhershëm. Më të spikaturit ndër këta faktorë kanë qenë: konflikti në Maqedoni dhe bllokimi i importeve, sidomos i frutave dhe perimeve, rritja e shpallur e pagave buxhetore dhe pensioneve në muajin korrik, përqendrimi i shpenzimeve buxhetore të gjashtë muajve të parë të vitit, në muajt maj e qershor apo reduktimi i prodhimit bujqësor të vendit;
- pritshmëri për rritje të presioneve inflacioniste për pjesën e mbetur të vitit, sidomos nën ndikimin e krizës energjitike dhe të rritjes së çmimit të energjisë elektrike nga prezantimi i sistemit të ri dytarifor të pagimit.

Të gjitha këto fenomene bënë që Banka e Shqipërisë, në muajin gusht, të merrte vendimin për rritjen e normës së interesit të repove me 0.5 pikë përqindjeje. Ky veprim synonte të përçonte në treg sinjalin se nuk ishte i dëshirueshëm reduktimi i mëtejshëm i normave të interesit në ekonomi, sidomos në krahun e fondeve (pasivit). Gjithashtu, nëpërmjet këtij veprimi pritej që të ndikoheshin sadopak pritjet inflacioniste nga ana e publikut për periudhën vijuese. Tashmë mund të them se është konfirmuar që shqetësimi i Bankës së Shqipërisë ishte mëse i justifikuar dhe vendimi u mor në kohën dhe në masën e duhur.

**Tabela 5: Seritë mujore të normës së inflacionit (në %).**

Muajt	1998	1999	2000	2001
Janar	3.46	0.91	0.63	-1.30
Shkurt	1.81	-0.61	-0.6	-1.30
Mars	1.16	-0.29	-1.11	0.30
Prill	1.61	0.01	0.72	0.85
Maj	-0.19	-0.64	0.67	0.20
Qershor	-1.74	-2.28	-2.1	-0.70
Korrik	-2.01	-1.30	-2.7	-2.20
Gusht	0.41	-0.28	0.39	-1.00
Shtator	1.45	0.10	1.7	1.10
Tetor	0.26	0.39	1.3	-0.40
Nëntor	0.21	0.78	0.7	
Dhjetor	2.05	2.25	4.6	

Burimi: INSTAT.



Inflacioni vjetor në fund të muajit tetor arriti në nivelin 1.8 për qind duke shënuar një reduktim mujor prej 0.4 për qind. Reduktimi i inflacionit në muajt shtator e tetor mendohet se ka ardhur si pasojë e qëndrueshmërisë (me kah mbiçmimi) të monedhës së vendit, e pranisë në treg të prodhimeve të stinës së vjeshtës, e reduktimit të përgjithshëm të çmimeve të mallrave në tregjet botërore, e “qetësimit” të intensitetit të kryerjes së shpenzimeve buxhetore, të cilat siç kemi theksuar dhe më parë japin një efekt të vonuar prej rreth tre muajsh.


**Tabela 6: Shpenzimet mujore buxhetore (në miliardë lekë).**

Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor
14.5	13.5	9.9	11.2	11.4

Burimi: Banka e Shqipërisë. Shpenzimet janë raportuar sipas datës së regjistrimit.

**Tabela 7: Kursi mesatar mujor i këmbimit.**

	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor
USD / LEK	148.5	147.8	143.2	142.6	141.3
Euro / LEK	126.8	127.1	128.8	129.8	128.1




Burimi: Banka e Shqipërisë.


**Grafiku 2.**

Duke patur parasysh këtë ecure, reduktimin e përgjithshëm të çmimeve të mallrave dhe të naftës në tregun ndërkombëtar, ngadalësinë e reagimit të tregut shqiptar ndaj reduktimit të çmimit të mallrave në tregjet ndërkombëtare, një rritje të mundshme të shpenzimeve buxhetore në fund të vitit, rritjen spekulative të çmimeve në muajin dhjetor, situatën aktuale në Maqedoni si dhe prezantimin e sistemit të ri të pagimit të energjisë elektrike në fillim të muajit dhjetor, Banka e Shqipërisë gjykon se objektivi për inflacionin është i arritshëm dhe ajo synon të afrohet në nivelin 2 për qind.

Bazuar në këtë synim, në reduktimin e normave të interesave në valutë dhe të nevojës për të nxitur rritjen ekonomike, Banka e Shqipërisë ka vlerësuar se politika më e përshtatshme në lidhje me normat e interesit është ajo neutrale, pra ruajtja e nivelit aktual të tyre, sidomos për sa i përket interesave të depozitave dhe bonove të thesarit, dhe reduktim i interesave të kredisë, sidomos atyre në valutë pasi ka mjaft hapësira.




Grafiku 3.



Grafiku 4.







Grafiku 5.

## II.1. Kategoritë e inflacionit.

Për të marrë vendime sa më të matura dhe realiste, Banka e Shqipërisë bazohet edhe në kategori të tjera të inflacionit që llogariten prej saj. Më konkretisht, shqyrtohet inflacioni bazë dhe inflacioni i llogaritur sipas shportës së re. Nga kategoria e parë përfitohen të dhëna të cilat paraqesin ecurinë e çmimeve të mallrave më të qëndrueshëm të shportës ose ecurinë e indeksit të çmimeve të konsumit ku është reduktuar ose eliminuar ndryshimi i shkaktuar nga lëvizjet e mëdha (konsiderueshme) të disa produkteve, nën ndikimin e faktorëve të rastit. Inflacioni, sipas shportës së re, llogaritet sipas të dhënave paraprake të vrojtimit për nivelin e jetesës të kryer nga INSTAT. Kjo kategori jep një përafrim më të mirë me inflacionin real. Në këtë mënyrë, rritet mundësia që vendimet të merren mbi bazën e të dhënave statistikore më të sakta. Por, dua të sqaroj edhe një herë, për të shmangur çdo keqkuptim, shifra zyrtare e inflacionit publikohet nga INSTAT. Inflacioni bazë dhe inflacioni me shportën e re janë llogaritje të Bankës së Shqipërisë, jo të dhëna zyrtare. Ato publikohen në kuadrin e rritjes së transparencës për procesin vendimmarrës të politikës monetare. Inflacioni i saktë dhe përfundimtar, sipas shportës së re, do të publikohet nga INSTAT në vitin 2002.



Grafiku 6.



Grafiku 7.

### III. ZHVILLIMET NË SISTEMIN BANKAR SHQIPTAR

Është bërë traditë që çdo deklarim për zhvillimet në sistemin bankar ta nisim nga numri i subjekteve të tij dhe shtrirja e tij gjeografike. Kjo ndodh sepse shtrirja e sistemit bankar është një tregues i drejtpërdrejtë i zgjerimit të aktivitetit bankar dhe, për rastin e vendit tonë, ku në mjaft zona të vendit mungojnë shërbimet bankare dhe konkurrenca bankare, një zhvillim i tillë është i mirëpritur. Gjatë këtij viti, sistemi bankar vazhdon të numërojë 13 banka tregtare ndërkohë që në muajin prill i është dhënë licenca paraprake edhe bankës së katërbëdhjetë – Bankës Tregtare të Kuvaitit. Nga ana tjetër, është zgjeruar shtrirja e bankave në rrethet e vendit dhe mund të përmend që Banka Kombëtare Tregtare vepron në



7 rrethe, Banka Tirana, Banka Alfa dhe Banka Fefad në 3 rrethe secila, Banka Kombëtare Greke në 2 rrethe, Banka Amerikane, Banka Italo Shqiptare (përveç Tiranës ku operojnë 4 degë) dhe Banka Arabo-Shqiptare Islamike në 1 rreth secila, pa përmendur Bankën e Kursimeve që vepron në të gjitha rrethet. Gjatë këtij viti janë hapur 6 degë të reja, vetëm dy prej të cilave janë çelur këto ditët e fundit në Shkodër dhe në Gjirokastrë.

Përgjithësisht, sistemi bankar shqiptar pasqyron një gjendje relativisht të qëndrueshme, i mbështetur dhe nga stabiliteti makroekonomik i arritur. Aktiviteti bankar është zgjeruar me rreth 11.2 për qind krahasuar me fundin e vitit 2000. Ndikimin kryesor në këtë rritje e japin bankat private dhe ato me kapital të përbashkët (25.5 për qind). Megjithatë, peshën kryesore në aktivet e sistemit vazhdon ta ketë Banka e Kursimeve me 60.2 për qind, kundrejt 64.8 për qind që zinte në vitin 2000.

Aktiviteti i sistemit bankar vazhdon të jetë i përqendruar kryesisht në bono thesari, vendosje pranë bankave jorezidente dhe letra të tjera me vlerë e më pak në kredidhënie, pavarësisht se është vërejtur një përmirësim i lehtë i strukturës së aktiveve në drejtim të angazhimit në aktivitete më fitimprurëse. Vlen për t'u përmendur që, në muajin gusht 2001, Banka Kombëtare Tregtare filloi të angazhohet në aktivitetin huadhënës duke rritur mundësitë për zgjerim të mëtejshëm të kreditimit në vitin e ardhshëm.

**Tabela 8: Struktura e zërave kryesorë të bilancit (në %).**

Zërat	31/12/2000	30/09/2001
<b>Aktivët</b>		
Bono thesari	55.5	54.1
Vendosje pranë bankave jorezidente	20.6	21.4
Kredidhënia	6.1	7.0
Letrat e tjera me vlerë	2.9	3.5
<b>Pasivët</b>		
Burimet e të tretëve	87.1	87.9
Burimet e përhershme	7.1	7.0
Nga këto: kapitali aksioner	6.7	6.7

Burimi: Banka e Shqipërisë.

Megjithëse flasim për një mjedis makroekonomik të qëndrueshëm, bankat vazhdojnë të mos shtrihen shumë në kredidhënie. Nga njëra anë (kur flasim për bankat), faktor i rëndësishëm mund të gjykohej mangësitë në kuadrin ligjor në vend (si hipoteka etj.) apo bilancet joreale të biznesit, mungesa e traditës së bizneseve për të punuar me bankat etj., dhe nga ana tjetër (kur flasim për bizneset) bizneset e përdorin pak kredinë bankare pasi tregu jozyrtar i kredisë u ofron këtyre të fundit

shërbim më të shpejtë dhe pa burokraci dhe në çdo moment kohor etj.. Kështu, edhe në këtë periudhë të vitit kredia neto për sistemin relaton rritje (28.3 për qind) në krahasim me vitin 2000 dhe shpërndarja sipas sektorëve evidenton sektorin privat (rreth 80 për qind të tepricës së kredisë) si më të favorizuarin nga sektori bankar.

Cilësia e portofolit të kredisë vlerësohet relativisht e mirë.

Kreditë me probleme ndaj tepricës së kredisë gjithsej përfaqësojnë vetëm 11,4 për qind dhe rreth 53 për qind e tyre janë të mbuluara me fonde rezervë.

**Tabela 9: Cilësia e portofolit të huave.**

Treguesi	31/12/2000		30/09/2001	
	Sistemi bankar	Bankat private (G2+G3)	Sistemi bankar	Bankat private (G2+G3)
Teprica e kredisë (në miliardë lekë)	28.2	16.1	22.8 *	21.7
Kredi me probleme** (në miliardë lekë)	12.1	1.6	2.6	2.5
Kredi me probleme ndaj tepricës së kredisë (në %)	42.8	9.7	11.4	11.6
Provizionet e krijuara (në miliardë lekë)	11.5	0.8	1.4	1.3
Provizione ndaj kredive me probleme (në %)	95.1	51.3	53.0	51.9

Burimi: Banka e Shqipërisë.

\* BK ka kaluar në ATK kredi me probleme 10 277.8 milionë lekë.

\*\* Përfshihen kreditë nënstandarde, të dyshimta dhe të humbura.

Burimet nga të tretët (depozitat) vazhdojnë të mbeten burimi bazë i fondeve të bankave, krahas tendencës në rritje që shfaq edhe kapitali aksioner i vetë bankave. Sipas kontributit të sektorëve, janë individët ata që zënë peshën kryesore (64.7 për qind të totalit të depozitave) në depozitat e sistemit, të cilat vazhdojnë të jenë të përqendruara në Bankën e Kursimeve (dominuese në grumbullimin e depozitave). Por, ndërsa Banka e Kursimeve vazhdon të zërë peshën më të madhe në depozitat e sistemit, rritja e depozitave (11.5 për qind në krahasim me vitin 2000) gjatë kësaj periudhe i dedikohet kryesisht bankave private, të cilat kanë filluar të thithin më shumë burime nga të tretët (klientët).

Struktura e bilancit dikton dhe strukturën e të ardhurave dhe shpenzimeve të sistemit. Sistemi vazhdon të gjenerojë të ardhura kryesore nga interesat (bono thesari, vendosje pranë bankave dhe kredidhënie). Rezultati financiar i sistemit evidentohet pozitiv (rreth 3.7 miliardë lekë fitim ose 37 për qind më shumë se e njëjta periudhë e vitit të kaluar). Ndikim pozitiv në rezultatin financiar të sistemit jep edhe rezultati nga veprimtaritë e tjera (rreth 1.7 miliardë lekë) që rrjedh kryesisht nga komisionet dhe nga veprimtaria valutore.



Treguesit<sup>3</sup> e rentabilitetit - përkatësisht, kthyeshmëria nga aktivet evidentohet 1.7 për qind (në nivelet e pranueshme mbi 1 për qind) dhe kthyeshmëria nga kapitali paraqitet e qëndrueshme (25.1 për qind) në këtë periudhë dhe me rritje në krahasim me vitin 2000. Treguesit flasin për një sistem bankar eficient dhe në rritje.

Edhe raporti i mjaftueshmërisë së kapitalit paraqitet në nivele të kënaqshme (30 për qind), me tendencë në ulje në krahasim me vitin 2000, që flet për shtrirje të aktivitetit të bankave në veprimtari me rrezik. Aktivitetet e sistemit të ponderuara me rrezikun janë rritur për rreth 26 për qind në krahasim me vitin 2000. Niveli i lartë i mjaftueshmërisë së kapitalit i krijon mundësi bankave të sistemit për zgjerimin e mëtejshëm të veprimtarisë së tyre sidomos në kredidhënie.

Duke gjykuar nga sa thamë më sipër, ndonëse Banka e Kursimeve paraqitet me tendencë në rënie të pozitive monopol në sistem dhe bankat private po bëjnë progres, përsëri ajo mbetet banka më e madhe dhe me peshë të konsiderueshme në sistemin bankar.

### **III.1. Privatizimi i Bankës së Kursimeve.**

Në vitin 2001 ngjarja më e rëndësishme për sistemin bankar do të ishte privatizimi i Bankës së Kursimeve. Megjithatë, kjo nuk ndodhi dhe siç jeni në dijeni nga bisedimet me FMN-në është pranuar shtyrje e afateve të dhëna. Kjo ndodh pasi, për vetë rëndësinë që paraqet Banka e Kursimeve, ka shumë rëndësi cilësia e investitorit strategjik të saj. Nga ana tjetër, ngjarjet që ndodhën paralelisht me këtë proces si zgjedhjet e përgjithshme, situata në të cilën përgjithësisht investitorët stepen, konflikti në Maqedoni, i cili shtoi rrezikun e rajonit për investim si dhe kriza financiare që përfshiu Turqinë, e në veçanti sistemin e saj bankar, ishin faktorë të mjaftueshëm për të ngurtësuar deri-diku procesin. Nga ana tjetër, fushata informative me të cilën u shoqërua ky proces nuk ishte e mjaftueshme.

Banka e Shqipërisë sugjeron, për periudhën në vazhdim, shtimin e kontakteve të vazhdueshme me investitorët e huaj të mundshëm, duke përfshirë jo vetëm përgatitjen dhe shpërndarjen e paketës për paraqitjen e bankës, por edhe përshkrimin e anëve pozitive të kësaj banke si dhe veçantitë e saj në raport me bankat e tjera në Shqipëri, por edhe në rajon. Gjithashtu, Banka e Shqipërisë sugjeron se krijimi i një sistemi të garantimit të depozitave, do të ishte pozitive të ecte paralelisht me

---

<sup>3</sup> Treguesit janë llogaritur në baza vjetore.

procesin e privatizimit. Në momentin e privatizimit të Bankës së Kursimeve ligji jo vetëm që duhet të jetë miratuar, por duhet të jetë krijuar dhe skema përkatëse dhe e gatshme për të funksionuar.

Objektivi është që, në muajin mars 2002 të përcaktohet lista e përzgjedhur e blerësve të mundshëm dhe në muajin qershor 2002, të organizohet tenderi nga ku përzgjidhet fituesi me të cilin do të fillojnë bisedimet.

Aktualisht po punohet në dy drejtime: reduktimi i mëtejshëm i pozitave dominuese të bankës dhe kontakti me investitorë të mundshëm. Kështu:

- Është konfirmuar pjesëmarrja e IFC, si një ndër aksionerët e mundshëm të Bankës së Kursimeve si dhe angazhimi për të luajtur një rol më aktiv në këtë proces, gjë që pritet t'i japë një shtytje pozitive privatizimit.
- Janë organizuar takime dypalëshe prezantuese me bankat më të mëdha në Itali, Austri, Zvicër, Gjermani e Angli.
- Ka përfunduar marrëveshja e re me ATK-në për transferimin kontabël të kredive të këqija dhe është realizuar transferimi, masë e cila ndikon në pastrimin e llogarive të bilancit.
- Ka përfunduar marrëveshja midis Bankës së Kursimeve dhe Albapost për të asistuar këtë të fundit në procesin e përmbushjes së kushteve për marrjen e licencës si subjekt financiar jobankë edhe në rrethet e tjera të vendit. Kryerja nga Albaposta e aktivitetit të pensioneve, ndikon në uljen e pozitës dominuese të Bankës së Kursimeve.
- Është përzgjedhur nga IFC dhe vazhdon punën, eksperti për hartimin e planit të biznesit të Bankës së Kursimeve për vitin 2002 e më tej.
- Ka përfunduar çertifikimi ndërkombëtar i rivlerësimit të aktiveve të qëndrueshme të Bankës së Kursimeve, masë e cila i bën të krahasueshme me tregun ndërkombëtar aktivet e bankës.
- Ka përfunduar raporti i auditimit nga KPMG për gjashtëmujorin e parë të vitit 2001.



- Degët po punojnë për përgatitjen e strukturave të reja, për t' i lehtësuar ato nga elementet jorentabël.

Ulja e pozicionit dominues të Bankës së Kursimeve mund të realizohet përpara transferimit të aksioneve tek blerësi (deri në fund të vitit 2002), nëpërmjet marrjes së masave të mëposhtme:

Kalimi i aktivitetit të pagimit të pensioneve, sidomos në disa qytete të mëdha si Durrësi, Korça, Fieri, Vlora etj., (pa përjashtuar si mundësi edhe Tiranën) nga Banka e Kursimeve tek Albaposta. Ky kalim mund të realizohet nëpërmjet një plani të hartuar bashkërisht nga Banka e Kursimeve, Albaposta dhe Instituti i Sigurimeve Shoqërore, duke filluar nga 1 janari i vitit 2002.

Nuk mund të përjashtohet si mundësi tjetër, që ISSH-ja të liberalizojë pagesën e pensioneve, duke futur këtu si shërbim pagesën e pensioneve edhe në bankat private ose pagesën e tyre me çek.

Aktualisht, pagesat e buxhetit për entet buxhetore bëhen edhe nga Banka Fefad vetëm në rrethin e Elbasanit, në zbatim të një projekti-pilot. Ministria e Financave, duke filluar nga 1 janari i vitit 2002, mund ta liberalizojë këtë shërbim në disa qytete të mëdha si Durrësi, Korça, Fieri, Shkodra, Gjirokastra etj. (pa përjashtuar si mundësi edhe Tiranën, ku aktualisht realizohet 50 për qind e këtij shërbimi) duke ja kaluar bankave të tjera që operojnë në këto rrethe.

Pavarësisht nga faktorët e mësipërm, gjatë periudhës në vazhdim, deri në transferimin e aksioneve në fund të vitit 2002, forcat e tregut do të kenë ndikimin e tyre në uljen e pozicionit dominues të Bankës së Kursimeve, sidomos për depozitat, në ato qytete ku bankat private po shtrijnë aktivitetin e tyre.

#### **IV. HYRJA NË QARKULLIM E EUROS**

Më 1 janar 2002, monedha europiane euro do të hyjë në qarkullim. Kjo datë nuk shënon lindjen e kësaj monedhe, por prezantimin fizik të saj në formën e kartëmonedhave dhe të monedhave metalike. Prej 1 marsit 2002, euro do të jetë e vetmja monedhë për 12 shtetet anëtare të BE-së. Deri në këtë moment, do të ketë qarkullim paralel të euros dhe të monedhave përkatëse të këtyre 12 shteteve. Përfitoj nga rasti të bëj edhe një herë të njohur për publikun që duhet të kujdesen për të realizuar këmbimin e njësisve monetare kombëtare, që ata disponojnë aktualisht,

me euron. Ky këmbim sugjerojmë të bëhet në subjektet financiare të licencuara nga Banka e Shqipërisë (pra në sportelet e bankave tregtare dhe të zyrave të këmbimit valutor) me qëllim që të shmangen rastet e abuzimit apo të falsifikimeve. Këmbimi mund të bëhet në mënyra të ndryshme. Ai mund të fillojë që në këtë moment duke i vënë paratë që dispononi në depozita pranë bankave tregtare. Siç kanë njoftuar shumë banka të nivelit të dytë, depozitimi, para datës 1 janar 2002, do të bëhet pa komision. Pas 31 dhjetorit 2002, përsëri mund të vendosni depozita në bankat tregtare ose t'i këmbeni paratë në sportele bankash. Këmbimi fizik do të realizohet me ose pa komision në varësi të politikës së çdo subjekti financiar. Pas datës 1 mars 2002, monedhat të cilat nuk do të kenë mundur t'i këmbeni mund të ndërrohen pranë bankave qendrore të shteteve anëtare të BE-së.

Procesi i hyrjes fizike të euros në qarkullim po ndiqet me mjaft kujdes nga Banka e Shqipërisë me qëllim që të shmangët paniku apo rastet e abuzimit. Paralelisht, për këtë proces, po përgatiten si Banka e Shqipërisë ashtu edhe bankat tregtare. Banka Shqipërisë po punon për trajnimin e bankave tregtare si dhe edukimin e publikut. Informimi me këtë monedhë të re është realizuar nëpërmjet botimit të artikujve në publikimet e vetë Bankës së Shqipërisë, por edhe në shtypin e përditshëm ose në atë periodik, të shpërndarjes së fletëvolanteve, të posterave apo të broshurave. Në këto materiale, jepen të dhëna mbi monedhat dhe kartëmonedhat e euros, pamja e tyre si edhe elementet e sigurisë. Këto materiale informative në mënyrë intensive do të jenë në qarkullim deri në fund të dhjetorit të vitit 2001. Elementi i dytë i konsideruar si i dobishëm për këtë fushatë është kontakti me gazetarët, i cili është realizuar nëpërmjet seminareve dhe duke shfrytëzuar këtë konferencë shtypi. Brenda muajit nëntor do të organizohet një tjetër seminar me gazetarët për këtë problem. Qëllimi jonë është të tërheqim vëmendjen tuaj për të siguruar një fushatë sa më intensive dhe sa më të gjerë për të familjarizuar publikun me euron. Për çështje teknike janë organizuar një grup tjetër seminaresh me punonjësit e bankave tregtare me qëllim që ata të kenë mundësinë të njihen me euron. Këto seminare do të vijojnë me zyrat e këmbimit valutor. Përveç kësaj, të gjitha bankat do të pajisen me mjete të tilla si CD, videokasetë, broshurë udhëzuese dhe fletëpalosje me elementet e sigurisë, të cilat do t'i shërbejnë procesit të vetëtrajnitit. Në fazën e fundit të fushatës, do të shfrytëzohen mediat elektronike me anë të dhënies së intervistave apo të njoftimeve përkatëse. I gjithë ky aktivitet informues ka një qëllim të vetëm: të bëjë të njohur pranë publikut që do të zëvendësohen monedhat e 12 shteteve anëtare të BE-së me euron dhe që ky zëvendësim do të kryhet normalisht.





Prandaj, do të kërkoja që ju si gazetarë të përcillni tek publiku mesazhin e zhvillimit të një procesi normal, që njerëzit të mos përfshihen në vorbullën e panikut apo të mos bien pre e abuzimeve të ndryshme. Për të siguruar këtë, përveç masave të marra nga bankat e nivelit të dytë, edhe Banka e Shqipërisë do të krijojë rezervën e vet në euro.

Mbarëvajtja e këtij procesi informues është siguruar edhe falë bashkëpunimit të frytshëm me Bankën Qendrore të Gjermanisë, nëpërmjet të cilës janë dhënë në formë dhurate mjaft nga materialet informuese me fondacionin GTZ, i cili po ashtu ka mundësuar dhënien e materialeve informuese dhe është angazhuar në organizim seminaresh, si edhe me Institutin e Mediave me të cilin po bashkëpunojmë për të organizuar seminarin për gazetarët dhe ku unë ju ftoj të merrni pjesë. Në mënyrë të veçantë dua të falenderoj shkollën e mesme “Arben Broci” në kryeqytet, nxënësit e të cilës do të angazhohen në shpërndarjen në qytetin e Tiranës të mjaft materialeve informuese.

**Tabela 10: Afatet kohore për zëvendësimin e njësive monetare kombëtare europiane (NJMKE) të mbajtura si para fizike në euro në vendet e Bashkimit Monetar Europian.**

Shtetet	Data e fundit e funksionimit si njësi pagese ligjore e NJMKE	Ndërrimi i NJMKE në banka, pas përfundimit të funksionit si njësi pagese ligjore	Ndërrimi pranë bankave qendrore, pas mbarimit të afatit të ndërrimit në banka
(1)	(2)	(3)	(4)
Gjermania	31 dhjetor 2002	Të paktën deri në 28 shkurt 2002	Pafundësisht
Belgjika	Mesnata e 28 shkurtit 2002	31 dhjetor 2002	E papërcaktuar për kartëmonedhat ndërsa për monedhat metalike fundi i vitit 2004
Franca	Mesnata e 28 shkurtit 2002	30 qershor 2002	10 vjet për kartëmonedhat dhe 3 vjet për monedhat metalike
Italia	28 shkurt 2002	Vendoset individualisht nga bankat	10 vjet
Austria	28 shkurt 2002	Vendoset individualisht nga bankat pas 28 shkurtit 2002	Pafundësisht
Holanda	Mesnata e 28 janarit 2002	31 dhjetor 2002, por pas 1 prillit 2002 bankat mund të aplikojnë komisione.	1 janar 2007 për monedhat metalike dhe 1 janar 2032 për kartëmonedhat
Luksemburgu	28 shkurt 2002	30 qershor 2002	E papërcaktuar për kartëmonedhat ndërsa për monedhat metalike fundi i vitit 2004
Spanja	28 shkurt 2002	30 qershor 2002	Pafundësisht
Irlanda	Mesnata e të shtunës, 9 shkurt 2002	E papërcaktuar	Pafundësisht
Portugalia	28 shkurt 2002	30 qershor 2002	20 vjet për kartëmonedhat dhe fundi i vitit 2002 për monedhat metalike
Greqia	28 shkurt 2002	E papërcaktuar	10 vjet për kartëmonedhat dhe 2 vjet për monedhat metalike
Finlanda	28 shkurt 2002	Vendoset individualisht nga bankat	10 vjet

Burimi: Komisioni Europian, 9 korrik 2001.

Prania në publik e Guvernatorit të Bankës së Shqipërisë.

---

- (2) Afatet kohore në të cilat do të këmbehen njësitë monetare kombëtare europiane të mbajtura në para fizike në monedhën e re euro, pa komision.
- (3) Momenti kohor pas të cilit njësitë monetare kombëtare europiane pushojnë së qeni njësi pagese me kurs ligjor.
- (4) Momenti kohor pas të cilit njësitë monetare kombëtare europiane të mbajtura në para fizike nuk mund të ndërrohen më në euro pranë bankave.



**PYETJET E GAZETARËVE DHE PËRGJIGJET E GUVERNATORIT NË KONFERENCËN PËR SHTYP TË DATËS 19 NËNTOR 2001**

Pyetje- Nuri Dragoi(Gazeta"Republika"): ***Si e nxjerrin fitimin bankat, si del fitimi bankar?***

Përgjigje: Fitimi realizohet njëloj sikurse mund të realizohet fitimi në çdo sistem bankar në kohë. Natyrisht që shkalla e zhvillimit të një sistemi bankar ka strukturë të ndryshme të fitimit, por treguesit e fitimit ose kompozimi është thuajse i njëjtë kudo. Bankat marrin depozitat, të cilave u gjejnë vendin për të investuar. Në Shqipëri sistemi bankar i realizon fitimet nëpërmjet diferencës së interesave dhe diferenca e interesave është në kreditim, pra depozitë-kredi, diferenca e interesave është bono thesari ose *yield*-i i bonove të thesarit me depozita, është depozita në bankat tona dhe ridepozitim në bankat e huaja dhe element tjetër janë dhe komisionet bankare. Në material duhet të keni sa janë përkatësisht përqindjet e vendosjeve, sa është realizuar fitimi dhe sa janë përqindjet e vendosjeve në sistem në bono thesari, pranë bankave jorezidente, sa është kredithënia dhe sa janë letrat e tjera me vlerë.

Ornela Liperi (Revista "Monitor"): ***Ç'mund të thoni për procesin e privatizimit të Bankës së Kursimeve dhe ndryshimet në ligjin antimonopol për sistemin bankar dhe pozitën e Bankës së Kursimeve? A jeni dakort me të, pse në shtyp ka patur mjaft kritika?***

Përgjigje: Nuk ka asgjë të re në atë që unë do të shtoja tani për uljen e pozitës dominuese të Bankës së Kursimeve. Është një diskutim i tërë: monopol apo dominues. Në fakt, në tërësi Banka e Kursimeve ka pozitë dominuese në sistem, kurse në aktivitete të caktuara ka edhe monopol. Për uljen e pozitës monopol janë paraqitur tre rrugë në material. Një është kalimi i pensioneve tek Albapost ose bankave të tjera; e dyta është kalimi i buxhetit drejt bankave të tjera. Rruga tjetër është zhvillimi i vetë sistemit bankar. Nuk pata kohë t'jua them, por rritja e aktiveve të bankave me 11.2 për qind pothuajse ka ardhur në pjesën dërrmuese nga bankat private. Pra, vetiu sistemi bankar po ecën drejt prishjes së dominimit të Bankës së Kursimeve edhe për shkak të zhdërvjelltësisë së bankave private. Ndërsa lidhur me ligjin, e kam ndjekur median. Natyrisht ka mendime të ndryshme. Një herë, pozita dominuese e Bankës së Kursimeve është një fakt. Është një fakt i cili ka vite që vërtetohet në Shqipëri dhe është në rënie. Ajo që e shqetëson Bankën e Shqipërisë është që ka mundësi që pozita dominuese të ulet më shpejt dhe ne këtë kërkojmë.

Ne nuk jemi kundër ligjit. Por, do të kundërshtojmë në rast se nuk jepet një planbiznesi konkret se si konkretisht secili pjesëmarrës ose pronar i Bankës së Kursimeve, pra si Ministria e Financave sot edhe pronari i ri, do të ulë, në tre ose katër vjet, pozicionin dominues të Bankës së Kursimeve në sistemin bankar, në mënyrë që sistemi bankar të mos ballafaqohet në fund të vitit 2004 ose 2005 (është e drejta e legjislativit ta vendosë këtë) me një fakt, që pozita dominuese nuk është ulur dhe ne të jemi përballë një realiteti që s'kemi ç'të bëjmë. Pra, ne duam sa do të ulet çdo vit dhe në ç'mënyrë do të ulet çdo vit. Ky është pozicioni i Bankës së Shqipërisë. Pozicioni i Bankës së Shqipërisë është bërë publik në një deklaratë lidhur me konkurrencën. Duhet të jetë 6 ose 9 muaj më parë.

**Bardhi Sejdarasi (Revista "Monitor"): *Kam tre pyetje. Ju keni thënë në një konferencë shtypi në gusht se vendi është në prag të një krize energjitike dhe për këtë ju kanë etiketuar si alarmist. Tani që jemi në mes të kësaj krize, si e shihni gjendjen? Së dyti, si i shikoni shpenzimet e buxhetit të shtetit për këtë periudhë? Së treti, opiniononi është i shqetësuar për mosfunksionimin e gjatë të bursës. Çfarë po bën Banka e Shqipërisë për të dalë nga kjo gjendje?***

Përgjigje: Këtë të parën e prisja si pyetje. Është e vërtetë që unë fola në gusht për këtë. Është e vërtetë që të tërë flasin për krizë. Të tërë e dimë. Mirë do të jetë që ju t'i drejtoheni atyre që janë specialistë, se si ta rregullojnë. Mund të jetë e vërtetë që mund të dukem i etiketuar ashtu siç thoni ju. Nuk besoj që kanë vlera etiketimet personale në këtë çast. Ne jemi bashkëvuajtës të krizës energjitike. E mira do të jetë që ju, si media, të jeni më të përqendruar tashmë në mënyrën e zgjidhjes, që të krijojmë bindjen të tërë bashkë që kjo krizë do të kapërcehet me sukses. Lidhur me buxhetin. Buxheti deri tani nuk ka shqetësime. Ka një shpërndarje më proporcionale të buxhetit. Ndoshta dhjetori do të jetë diçka më i ngarkuar përsëri në shpenzimet buxhetore, por pa shqetësim. Lidhur me bursën. Edhe kjo pyetje nuk na përket shumë, për arsye se nuk jemi ne, në bazë të ligjit, promotorët e kësaj lëvizjeje. Unë, siç e kam thënë në gusht, e them përsëri se bursa është e gatshme, punonjësit e bursës janë në Bankën e Shqipërisë për të ndihmuar në kalimin e saj në duart e pronarëve të rinj. Është tashmë Ministria e Financave dhe ajo e Privatizimit që po punojnë në këtë drejtim. Unë para një jave pata takim me të dy ministrat përkatës dhe Ministri i Financave po ndjek procedurat në gjykatë për ta kaluar në sh.a. bursën-(të paktën kështu më tha-). Ne kemi nisur letrën tjetër në vazhden e letrave, për të kujtuar që kërkohet realizimi i kësaj detyre sa më në kohë. Ajo që unë mendoj



se është domosdoshmëri është aktiviteti i bursës. Dhe kjo është kryesore. Por, unë kam bindjen që viti 2002 do të jetë një vit që do të japë diçka të re në tregun e kapitaleve. Ndoshta do të jem gabim. Natyrisht që të jesh optimist dhe kur e heq nga duart tregun e kapitaleve, mund t'ju duket diçka pak si jo fort e këndshme. Por, është një bindje e brendshme e imja që ekonomia ka nevojë për tregun e kapitaleve dhe do të imponojë që tregu i kapitaleve të zhvillohet. Natyrisht që kërkohet edhe mbështetje e institucioneve ndërkombëtare, që nga sa jam në dijeni, do të jenë prezentë në zhvillimin e tregut të kapitaleve në Shqipëri.

Linda Spahia (Reuters): ***Si do të realizohet mbajtja e inflacionit 1.8-2 për qind kur thatë se dhjetori do të sjellë inflacion të rritur?***

Përgjigje: Inflacioni ndikohet nga një mori faktorësh që unë u mundova t'i përmend shkurtazi. Shqipëria me shportën e vjetër ka rreth 70 për qind ndikim nga ushqimet. Është nga 6-8 për qind ulja e çmimeve të ushqimeve në botë. Pra, ka një rënie që do ta quaja drastike. Vetë kriza ose regresi në ekonominë botërore, në rradhë të parë, jep goditjet në lëndët e para. Ekonomia shqiptare nuk është kaq shumë e integruar në ekonominë botërore. Mendohet diku nga 2-3 për qind është eksport-importi në PBB në Shqipëri. Duke qenë kaq pak e integruar, efekti i ekonomisë botërore në Shqipëri është ose i pakët, ose i vonuar. Pra, rënia e çmimeve në produktet bujqësore, rënia e çmimit të naftës deri në 14 për qind dhe që duket që tendenca është në rënie, të paktën nuk do të ketë rritje, me një vonesë faze, përsëri do të japë efekte. Dhe duke qenë kompozuesi kryesor, pra në 70 për qind natyrisht që do të japë efekt në ulje të çmimit. Duket që edhe kriza maqedonase do të ketë efektin e vet.

Ndërkohë, çmimi i energjisë elektrike natyrisht që është një faktor që ndikon në drejtimin e kundërt. Por, është një faktor i menjëhershëm dhe fillon më 1 dhjetor. Natyrisht, që efektet do të jenë me diçka të sfazuar. Ne flasim për inflacionin e këtij viti, ndërsa për vitin tjetër natyrisht që do ta ketë efektin e vet. Jo se s'ka efekt tani, por do të kompensohet dhe nuk do të jetë një inflacion që do të ketë një ndikim kaq të fuqishëm në rezultatin e këtij fundviti.

Enkelejda Myftari (Gazeta "Ekonomia"): ***Futja e euros në Shqipëri a do të shoqërohet me probleme për njerëzit?***

Përgjigje: Nuk e mendoj që do të jetë problem. Ne me njeri-tjetrin kemi qenë gjithnjë të sinqertë. Unë nuk e parashikoj dot se çfarë do të ndodhë.

Një nga problemet që unë mendoj se do të jetë është zbatimi i ligjit për pastrimin e parave. Njerëzit që do të kenë para të pista, natyrisht, që do të ballafaqohen me probleme. Ndërsa pjesa tjetër e popullsisë, natyrisht me këtë fushatë që kemi organizuar dhe që mendojmë se do të intensivikohet në fund të vitit besoj se nuk do të ketë probleme. Madje, unë do ta quaja pjesë të fushatës edhe këtë takim tonin. U mundova që ta kem euron çështjen e parë të diskutuar, përveç asaj të takimit me FMN-në. Më duket që gjërat janë thënë copë, që njerëzit kanë kohën e mjaftueshme që tani t'i vihen këmbimit të monedhave që ata kanë. Por, gjërat mund të thuhet një çikë me një sens shumë më praktik. Pra, që nga kjo datë deri më 31 dhjetor sistemi bankar është i hapur për të gjithë shtetasit shqiptarë, që ata të depozitojnë të gjitha valutat që kompozojnë sot euron dhe nesër do të kthehen në euro. Pra, edhe një herë, është marka gjermane, dhrahmia, lireta, është franga franceze, që janë monedhat më të prekshme në Shqipëri. Mund të ketë edhe peseta spanjolle, por në një volum më të vogël. Me sa duket, dhe pa komision, bankat janë të hapura për t'i pranuar të tëra këto në depozita. Qytetarët, duke i depozituar për dy muaj, për shembull, në janar 2002 i marrin në euro këto para, duke realizuar këmbyeshmërinë. Që nga 1 janari deri më 28 shkurt, unë nuk e di, me apo pa komisione, është e drejta e bankave tregtare, të gjitha bankat janë të gatshme të pranojnë depozita një mujore, dymujore, tremujore, etj. e t'jua kthejnë në euro. Pra, qytetarët mund të realizojnë kthimin në *cash*. Por, njëkohësisht mund të realizojnë edhe *cash* për *cash*, pra të dorëzojnë marka gjermane dhe të marrin euro. Pra, është një hapësirë mbi tre muaj që shqiptarët dita-ditës mund të këmbejnë lirshëm markat, liretat, dhrahmitë që kanë, në euro.

Vilma Baçe (TV TopChannel): ***A është llogaritur se sa euro duhen për të plotësuar nevojat e qytetarëve?***

Përgjigje: Ne i kemi bërë llogaritjet tona dhe unë ju thashë: mbi bazën e llogaritjeve që kemi bërë, secila bankë dhe vetë Banka e Shqipërisë, jashtë llogaritjeve të vetë bankave, do të kemi rezerva në euro. Ne jemi takuar me bankat. Do të vazhdojmë kontaktet. Nga 1 dhjetori deri më 31 dhjetor vazhdon furnizimi i sistemit bankar shqiptar me euro. Në të gjithë botën është e njëjta gjë. Kështu që të gjitha bankat i dinë nevojat e tyre. Ka edhe një kufizim fizik të shpërndarjes së euros. Jo çdo ditë mund të shpërndash më shumë se "X" para, sepse dhe fizikisht nuk i bën dot. Janë bërë llogaritje të sakta. Por, sistemi bankar është i gatshëm të këmbejë pa asnjë shqetësim të gjitha markat në euro që nga data 1 janar. Kuptohet, 1 janari do të jetë pushim. Por, ndërkohë janë dhe të



gjitha zyrat e këmbimit. Supozojmë se lindin nevoja shtesë. Është Banka e Shqipërisë që do të marrë rezervë në euro, për të mbështetur sistemin bankar. Duhet të dini një gjë dhe nga ana praktike. Supozojmë se në datën 3 janar u shpërndanë 10 milionë euro. Është një shifër e madhe. Në datën 8, bankat menjëherë mund të marrin euro nga Europa. Nuk ka problem, sepse merr me avion të tjera euro. Pra, rezervat janë menduar që të jenë në një javë-dy javë. Pra, i gjithë sistemi bankar të ketë këtë rezervë, veç rezervës, edhe një herë, të vetë Bankës së Shqipërisë. Dhe lehtësisht ky sistem i tëri kalon marka, lireta, drahmi me avion në shtetet përkatëse dhe ndërkohë merr euro për të zëvendësuar këto para. Pra, nuk është një proces kaq i vështirë sa duket fillimisht. Por, janë bërë llogaritjet nga i gjithë sistemi dhe ne kemi krijuar bindjen se këto llogaritje janë me rezervë brenda. Pra, jo vetëm janë krijuar rezervat për të përmbushur detyrimet, por edhe me rezervë brenda.

Bardhi Sejdarasi (Revista "Monitor"): ***Njerëzit i tërheq tregu i këmbimit. A ju shqetëson loja e disa bankave me drahmitë?***

Përgjigje: Për të na shqetësuar nuk është një shqetësim i madh, sepse është e drejta e individit të bëjë atë që gjykon. Bankës së Shqipërisë i intereson të sigurojë opinionin publik që sistemi bankar dhe institucionet e licencuara prej saj të mos lejojnë panikun dhe spekulimin. Ne do t'i trajnojmë bankat dhe byrotë e këmbimit edhe se si është euro, që të mos jetë falso.

Ne përpiqemi që euro të hyjë sa më natyrshëm. Ndërsa këmbimet janë në duar të individëve. Ne themi që ne jemi të gatshëm, pra sistemi bankar i tëri është i gatshëm që të realizojë pa asnjë shqetësim këmbimin e valutave përbërëse të euros, të cilat do të dalin nga qarkullimi në 28 shkurt, në euro. Ndërsa shqiptarët kanë të drejtën e tyre për të vendosur nëse do t'i mbajnë paratë në lekë, në dollarë, në euro apo qoftë edhe në marka gjermane. Sepse, dikush do të thotë që "...edhe pse del marka nga qarkullimi, unë do t'i këmbëj në Bankën Qendrore të Gjermanisë pas datës 28 shkurt". Dhe Gjermania për shembull, e ka pa kufi këmbimin, por do të shkosh në Bankën Qendrore të Gjermanisë. Mund të jetë kënaqësi e dikujt që ta realizojë këtë.

Ajo që ka për detyrë Banka e Shqipërisë është që shqiptarëve t'u krijojë të gjitha lehtësitë e mundshme. Por, që të dalim në atë konkluzionin që thoni ju tani, ne duhet të shihnim një efekt edhe në fushën e këmbimit. Pra, do të kishim një kërkesë të madhe për dollarë dhe duhej të ishte rritur kursi. Ne nuk e kemi parë deri tani. Mund të jetë e vërtetë kjo e

juaja. Duhet të ketë shenja. Por, më tepër mund të jetë psikologjike. Ideja ime është që shqiptarët, krejt natyrshëm, do t'i këmbëjnë në atë valutë që ata do të gjykojnë për t'i këmbyer.

Ornela Liperi (Revista "Monitor"): **Mund të jepni një shifër ekzakte se sa është shuma e parave europiane (marka gjermane, lireta, dhrahmi etj.) që ndodhen në Shqipëri?**

Përgjigje: Këtë mund t'ju jepja, por nuk do t'ju hynte në punë dhe s'ka lidhje me çfarë diskutuam ne deri tani. Një sekondë: kujton ndonjeri nga Banka e Shqipërisë sa është ajo shifër? Është sa një e treta, afërsisht sa një e treta. Duhet të jetë diku tek 100 milionë dollarëshi. Apo ju doni vetëm këto? Afërsisht duhet të jenë tek 50 milionë dollarë ose 40 milionë. Jo më shumë. Por kjo nuk ka lidhje me euron, sepse ato janë të këmbyeshme në euro vetiu. Sepse më 1 janar ato i tërheqin në euro shtetasit, kështu që nuk është problemi që po diskutojmë.

Alban Beqa (Gazeta "Zëri i Popullit"): **Cili është mendimi Juaj lidhur me projektbuxhetin e shtetit për vitin 2002, të miratuar nga Qeveria Shqiptare?**

Përgjigje: Ju thashë që me FMN-në takimi ka qenë jo vetëm për politikën monetare, por për të harmonizuar politikën monetare, fiskale dhe politikën ekonomike të vendit. Dhe ky është roli i programit afatmesëm dhe i programit për vitin 2002. Pra, të tre këta komponentë janë të harmonizuar në vetvete. Kurse, përsa i përket buxhetit në vetvete, meqë ju më bëtë një pyetje konkrete, ne ende nuk e kemi dhënë mendimin tonë lidhur me buxhetin, për arsye se në kohën që ne na erdhi buxheti, qeveria e miratoi. Kështu që ne do t'ja kthejmë përgjigjen Kuvendit meqë qeveria nuk e pa të arsyeshme, edhe pse është detyrimi ligjor për të na pyetur në bazë të nenit 24/2. Kështu që për atë, kur ta studjojnë departamentet përkatëse, ne do të japim vlerësimin dhe mendimin tonë konkret për gjëra konkrete. Ndërsa, harmonizimi tërësor mendoj që është realizuar në diskutimin tërësor që ne kemi bërë me misionin e FMN-së, midis Qeverisë dhe Bankës së Shqipërisë për programin afatmesëm dhe për programin e vitit 2002.

Enkelejda Myftari (Gazeta "Ekonomia"): **Mund të na jepni një koment tuajin për heqjen e përkohshme të kambistëve?**

Përgjigje: Komenti im është që kambistët janë hequr për arsye të një veprimtarie kriminale. Të paktën këtë dijeni ka Banka e Shqipërisë





nëpërmjet shtypit. Ata që i hoqën për veprimtari kriminale kanë gjykuar dhe kanë vepruar ndaj elementit kriminal. Mendoj që është vepruar në një rrugë të arsyeshme, që ju është lënë një afat provizor dhe ata të aplikojnë dhe të kërkojnë të zyrtarizohen. Ai është një treg jozyrtar, treg informal. Banka e Shqipërisë nuk mund të jetë në favor të ekonomisë joformale. Banka e Shqipërisë do të gëzohej që e tërë ekonomia shqiptare të jetë formale. Pra, lëvizja është drejt ekonomisë formale dhe ne e mbështesim ekonominë formale. Por, ne e kemi dhënë mendimin tonë tre muaj përpara për këtë, që është një treg që duhet të merret në konsideratë, për arsye se vlerësohet që ka gjysmën e aktivitetit të këmbimeve valutore. Ne po bëjmë një vërtetim tjetër, që deri nga fundi i nëntorit ne mendojmë ta realizojmë. Të dimë ku është gjendja e tregut të këmbimeve valutore në Shqipëri. Konkluzionet e këtij vërtimi ne do t'ua paraqesim diku nga fundi i dhjetorit ose fillimi i janarit. Pra, mendimi është i prerë: ne jemi për ekonomi formale. Nuk mund të jemi për joformale. Kjo është një normë normale dhe Banka e Shqipërisë është e gatshme të mirëpresë çdo aplikim. Deri tani janë nja 7-8 aplikime. Në një pjesë të tyre ende zyrtarizimi nuk janë gati. Por, deri në fund të vitit, mendoj se ata do të paraqesin kërkesat e duhura dhe Banka e Shqipërisë do të licencojë kërkesat e arsyeshme dhe në përputhje me rregulloren.